

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit Nr. 04/L-111),Bordi i Drejtorëve i KRU "Radoniqi - Dukagjini" në Gjakovë,ne mbledhjen mbajtur me datën 17.06.2022, lidhur me Konkursin e publikuar nr. 256 të datës 21.04.2022,mori këtë

V E N D I M

I.- Për plotësimin e vendit të punës-pozitës Këshilltar i Përgjithshëm – Sekretar korporativ, zgjedhet kandidati Blerim Pruthi, jurist i diplomuar nga Gjakova.

II.- Vendimi të u dërgohet të gjithë aplikuesve, në përputhje me nenin 8. Parg.3.,të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 , Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

A r s y e t i m

Komisioni përzgjedhës-vlerësues në mbledhjen e tij të mbajtur me datën 08.06.2022,ka bërë vlerësimin e dokumentacionit dhe testeve me shkrim dhe me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar sipas Konkursit të publikuar nr. 256 të datës 21.04.2022, dhe në bazë të rezultateve të kandidatëve ka bërë rangimin e tyre me pikë.

Duke u bazuar në Rang listën e përpiluar nga Komisioni përzgjedhës Bordi Drejtues i KRU " Radoniqi - Dukagjini", në Gjakovë, për plotësimin e vendit të lirë të punës-pozitës Këshilltar i Përgjithshëm - Sekretar korporativ, zgjodhi Kandidatin Blerim Pruthi, i cili është ranguar në vendin e parë me 89.6 pikë.

Duke u bazuar në këtë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE :

Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim, kanë të drejtë që në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, të ushtrojnë ankesë tek Inspektorati i Punës.

Kryetarja e Bordit Drejtues,

Mirlinda Kusari

